



Nr. _____, më _____

01.nr.031-48324, më 28-12-2012

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
E LIDHUR NË MES TË
QENDRËS RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË PRISHTINË
DHE
KOMUNËS SË PRISHTINËS

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje mirëkuptimi është zbatimi i projektit “Çezma në sheshin ‘Dr.Ibrahim Rugova’” në Prishtinë.

Angazhimet e Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prishtinë (QRTKP)

Neni 2

1. QRTKP do të zbatojë projektin në të gjitha fazat e realizimit të punimeve në çezmën në sheshin “Dr. Ibrahim Rugova” në Prishtinë,
2. QRTKP do të shpallë tenderin dhe do të bëjë përzgjedhjen e kontraktorit për zbatimin e projektit në përputhje me ligjet e prokurimit në fuqi,
3. QRTKP do të bashkëpunojë me Komunën e Prishtinës për realizimin e projektit,
4. Për zbatimin e projektit, QRTKP do t’i raportojë rregullisht Komunës së Prishtinës përmes raporteve mujore,
5. QRTKP do t’ia dorëzojë Komunës së Prishtinës raportin përfundimtar pas realizimit të projektit, sipas mjeteve të lejuara nga Komuna e Prishtinës.